

VENDIM
Nr. 147, datë 28.5.2026

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 198, DATË 15.8.2025, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘POWER ENERGY’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 25 mw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1694 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 25 mw’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Power Energy” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 198, datë 15.8.2025, i ndryshuar me vendimin nr. 278, datë 6.11.2025, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025 dhe jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës. Ndërsa në pikën 5 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Afati për vënien në operim të centralit brenda datës 31.12.2025 është përcaktuar duke iu referuar parashikimeve të vetë shoqërisë, ndërkohë që me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 382 prot., datë 28.1.2026, shoqëria ka bërë me dije se është pajisur me lejen e ndërtimit, dhe se parashikon që punimet për ndërtimin e centralit të fillojnë në datën 12.2.2026.

- Referuar pikës 1, germa “d”, të VKM-së nr. 310, datë 4.6.2025 dhe nenit 9, të kontratës nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.6.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të depozituara nga shoqëria në kuadër të licencimit, impianti fotovoltaiik duhet të vendoset, fillojë operimin brenda datës 4.6.2028. Shoqëria është brenda këtij afati, ndaj vlerësohet që dhe afati i pikës 3 të vendimit të jetë në përputhje me këto akte.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, të ndryshuar, si vijon:

a) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 4.6.2028.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti